VENDIM
Nr. 159, datë 19.3.2026

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE "REGJISTRI PËR EKZEKUTIMIN DHE VJELJEN E GJOBAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave" të Sistemit të Qendërzuar të Mbledhjes së Gjobave.
2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave" është Inspektorati i Përgjithshëm.
3. Të dhënat që përmban Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave ndahen në të dhëna parësore dhe në të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore:

i. Numri unik i identifikimit të gjobës.

b) Të dhëna dytësore:

i. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për të dhënat, si më poshtë:

- Emri;
- Emri i babait;
- Mbiemri;
- Numri personal;
- Datëlindja;
- Vendlindja;
- Gjinia;
- Shtetësia;
- Vendbanimi;
- Vendqëndrimi.

ii. Sistemi elektronik i gjobave të Policisë së Shtetit:

- Data;
- Ora;
- Adresa ku është vënë gjoba;
- Shkeljet ligjore;
- Vlera e gjobës;
- Masat plotësuese (heqje pikësh, heqje patente, pezullim patente).

iii. Sistemi *e-Inspektimi*:

- Institucioni (Inspektorati Qendror dhe ai vendor);
- Numri i vendimit përfundimtar (numër çështjeje);
- Data e vendimit;
- Subjekti;
- Shkelja ligjore;
- Dënimi administrativ gjobë (kryesore plotësues);
- Vlera e gjobës;
- Statusi i gjobës.

iv. Sistemi elektronik e-DPSHTRR për të dhënat që lidhen me të dhënat teknike të mjetit, duke përfshirë:

- numrin e regjistrimit;
- numrin e identifikimit të mjetit;
- llojin/tipin e mjetit;
- markën;
- emërtimin tregtar;
- ngjyrën;
- numrin e serisë së lejes së qarkullimit dhe të certifikatës së pronësisë;
- dokumentacionin vërtetues të gjendjes së mjetit.

v. Regjistri elektronik i tatimpaguesve i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të dhënat e tatimpaguesit:
- NIPT-i.

vi. Regjistri tregtar për të dhënat, si më poshtë:
- Emri i subjektit;
- NUIS;
- Aktiviteti;
- Data e regjistrimit;
- Statusi i subjektit;
- Përshkrimi i objektit;
- Adresa e subjektit;
- Adresa elektronike e subjektit;
- Numri i kontaktit të subjektit;
- Administratori.

4. Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave, si bazë të dhënash, funksionon, administrohet e ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave, në përputhje me pikën 9 të këtij vendimi.

5. Të dhënat e mbledhura nga Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave mund të përdoren për analiza dhe vlerësime. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave realizohet në përputhje me parimet e kriteret e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Të dhënat e Regjistrit për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave përditësohen periodikisht nga struktura përgjegjëse, sa herë është e nevojshme apo ka ndryshime të këtyre të dhënave.

7. Përdoruesit e bazës së të dhënave janë të përcaktuar në 4 nivele:

a) lexues;

b) institucion shtetëror;

c) administrator;

ç) auditues.

8. Për çdo veprim në Regjistrin për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, duhet të sigurohet gjurmueshmëria, me qëllim garantimin e konfidencialitetit e të integritetit, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit.

9. Baza e të dhënave të Regjistrit për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave ndërvepron nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave me bazën e të dhënave shtetërore:

a) Regjistri tregtar;

b) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

c) Sistemi elektronik i gjobave të Policisë së Shtetit;

ç) Sistemi *e-Inspektimi;*

d) Sistemi elektronik e-DPSHTRR;

dh) Regjistri elektronik i tatimpaguesve;

e) Regjistri i pronarëve përfitues.

10. Pagesa e gjobave do të bëhet *online* në portalin *e-Albania* nëpërmjet shërbimit të dedikuar elektronik, i ndërlidhur me platformën e pagesave elektronike, si dhe me mandatpagesë.

11. Ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për vendosjen e masës administrative "gjobë" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama